



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2018-01  
**Vendosi:** Gjykatësi i vetëm  
Gjykatës Nikola Giju  
**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon  
**Data:** 24 shtator 2020  
**Gjuha:** Anglishte  
**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i Redaktuar Publik i**

**Vendimit për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësve të Hysni Gucatit**  
Xhonatan Elistan Ris  
Hju Bauden

**Mbrojtësve të Nasim Haradinajt**  
Tobi Kadman  
Karl Bakli

**GJYKATËSI I VETËM**,<sup>1</sup> në përputhje me nenet 39(3), 53, 54, dhe 55 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 31, 32, 33, 37, 39, dhe 208(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtroi kërkesë për lëshimin e një fletarrestimi dhe urdhri për transferim kundër Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”), nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL-UÇK”).<sup>2</sup> ZPS-ja gjithashtu kërkoi, ndër të tjera, që gjykatësi i vetëm të autorizojë kontrollim dhe sekuestrim në lidhje me z. Haradinaj, vendarrestimin e tij dhe zyrat e OVL-UÇK-së.<sup>3</sup>

2. Më 23 shtator 2020, ZPS-ja plotësoi kërkesën e lartpërmendur me informacion për të dhënat personale të z. Haradinaj dhe vendndodhjen e zyrave të OVL-UÇK-së.<sup>4</sup>

3. Më 24 shtator 2020, gjykatësi i vetëm lëshoi fletarrestim për z. Haradinaj (“fletarrestimi”).<sup>5</sup>

## II. PARASHTRIMET

4. Krahas fletarrestimit për z. Haradinaj, ZPS-ja gjithashtu kërkon që gjykatësi i vetëm të autorizojë ZPS-në dhe/ose autoritetet zbatuese të fletarrestimit që në bashkëpunim

---

<sup>1</sup> KSCPR-2018, F00004, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>2</sup> KSC-BC-2018-01, F00125, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për lëshimin e fletarrestimeve dhe për Urdhra në lidhje me to*, 22 shtator 2020 (“Kërkesa”), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* 1-2..

<sup>3</sup> Kërkesa, para. 3, 27-30, 35(b).

<sup>4</sup> KSC-BC-2018-01, F00127, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim plotësues urgjent lidhur me parashtrimin e protokolluar KSC-BC-2018-01/F00125*, 23 shtator 2020 (“Parashtrim Plotësues”), rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* 1.

<sup>5</sup> KSC-BC-2018-01, F00128/A03, Paneli i përbërë prej një gjykatësi të vetëm, *Fletarrestim për Nasim Haradinajn*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

me ZPS-në: (a) të kontrollojnë z. Haradinaj, vendarrestimin e tij dhe zyrat e OVL-UÇK-së; dhe (b) të sekuestrojnë çfarëdo prove që besohet se është në lidhje me ose mund të jetë e rëndësishme për veprat penale sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe neneve 387, 388, dhe 392 të Kodit Penal të Kosovës 2019, nr. 06/L-074 ("Kodi Penal"), përfshirë materiale që pretendohet se janë të Task Forcës Hetimore Speciale ("TFHS") dhe/ose ZPS-së, si edhe çfarëdo prove tjetër lidhur me orvatjet e kohëve të fundit për pengimin e administrimit të drejtësisë ("kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar").<sup>6</sup> ZPS-ja vë në dukje se ndër sendet që do të sekuestrohen mund të përfshihen: kopje dokumentesh, fotografi, videoincizime, audioincizime, si dhe kompjuterë, telefona, memorie fizike pajisjesh për kopjim, dhe pajisje të tjera që logjikisht mund të pritet se përmbajnë prova relevante.<sup>7</sup>

5. ZPS-ja parashtron se ekziston dyshim i bazuar se z. Haradinaj ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, si dhe dyshim i bazuar se ai mund të ketë prova të domosdoshme për hetimin me vete, në zyrën e tij ose në vendin e arrestimit.<sup>8</sup>

6. ZPS-ja më tej parashtron se, duke marrë parasysh rrezikun e ndërhyrjes dhe pengimit,<sup>9</sup> provat që mund të ketë z. Haradinaj nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe kontrollimi e sekuestrimi gjatë arrestimit janë e vetmja masë e efektshme për sigurimin e provave për nevojat e hetimit.<sup>10</sup>

7. ZPS-ja parashtron se cenimi që do t'i shkaktohet të drejtës për privatësi dhe pronë të z. Haradinaj është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit dhe nuk eliminon thelbin e këtyre të drejtave.<sup>11</sup>

---

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 2, 27.

<sup>7</sup> Kërkesa, para. 27(b).

<sup>8</sup> Kërkesa, para. 28.

<sup>9</sup> Kërkesa, para. 21-23.

<sup>10</sup> Kërkesa, para. 28.

<sup>11</sup> Kërkesa, para. 29.

8. Së fundi, ZPS-ja kërkon autorizimin e mbajtjes në ruajtje të provave të sekuestruara për aq kohë sa është e nevojshme për vlerësimin e tyre, dhe në qoftë se provat gjykohe relevante, autorizimi të zgjatet për aq kohë sa është e nevojshme për hetimet dhe procesin gjyqësor.<sup>12</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Sipas rregullave 31 dhe 37 të Rregullores, kontrollimi i një personi, i pronës së tij ose i vendndodhjeve apo objekteve të tjera, si dhe sekuestrimi i çfarëdo prove të gjetur gjatë kontrollimit, mund të autorizohet në qoftë se:

- (a) ka pritshmëri të arsyeshme për privatësinë në lidhje me vendndodhjet që do të kontrollohen dhe sendet që do të sekuestrohen;<sup>13</sup>
- (b) lidhur me kontrollimin e vendndodhjeve dhe objekteve, ekziston dyshim i bazuar se (i) personi përkatës ka kryer, është duke kryer, ose është në prag të kryerjes së një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara;<sup>14</sup> dhe (ii) kontrollimi do të rezultojë, ndër të tjera, në zbulimin dhe sekuestrimin e provave të domosdoshme për hetimin. Lidhur me kontrollimin e personit, ekziston dyshim i bazuar se kontrollimi do të rezultojë në zbulimin e provave të një vepre penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe sekuestrimin e tyre;<sup>15</sup>
- (c) kontrollimi është i domosdoshëm për hetimin;<sup>16</sup>

---

<sup>12</sup> Kërkesa, para. 30.

<sup>13</sup> Rregulla 37(2) e Rregullores. *Shih gjithashtu*, KSC-CC-PR-2017-03, F00006, Dhoma e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 29 maj 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05-L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar*, 28 qershor 2017 (“Aktvendim i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të DHSK-së i 28 qershorit 2017”), para. 69..

<sup>14</sup> Rregulla 37(2)(a) e Rregullores.

<sup>15</sup> Rregulla 37(3) e Rregullores.

<sup>16</sup> Rregulla 31(1)(b) e Rregullores.

- (d) masa hetimore është e pashmangshme, d.m.th. në rrethanat konkrete provat nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër dhe kontrollimi dhe sekuestrimi që kërkohen duket se janë e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit;<sup>17</sup> dhe
- (e) cenimi që do t'i shkaktohet të drejtës së personit për integritet personal, privatësi apo pronë, është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit dhe nuk eliminon thelbin e të drejtës së garantuar.<sup>18</sup>

10. Sipas rregullës 37(4) të Rregullores, çdo vendim për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit përmban: (a) orarin, kohëzgjatjen dhe shkallën e kontrollimit dhe sekuestrimit, duke përfshirë të dhëna për personin ose pronën, vendndodhjen, mjediset ose objektin në lidhje me të cilat autorizohet masa përkatëse; dhe (b) procedurën e raportimit në lidhje me zbatimin e masës së autorizuar dhe materialin e sekuestruar, në përputhje me rregullën 31(2) të Rregullores.

11. Bazuar në rregullën 39(1) dhe (2) të Rregullores, kontrollimi dhe sekuestrimi duhet të kryhen në prani të personit përkatës, përveçse kur ky person nuk mund të gjendet ose refuzon të jetë i pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe kur vonesa në zbatimin e tyre do të rrezikonte hetimin apo sigurinë ose pronën e një dëshmitari, viktime apo personi tjetër të rrezikuar. Prokurori i Specializuar gjithashtu duhet: (a) t'i japë personit përkatës vendimin që autorizon kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit; (b) ta informojë personin në fjalë për të drejtat e tij; (c) të sigurojë praninë e mbrojtësit të personit, përveçse kur personi heq dorë nga ushtrimi i kësaj të drejte, apo logjikisht nuk mund të pritët prania e mbrojtësit; dhe (d) të sigurojë praninë e një vëzhguesi të pavarur gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit.

12. Bazuar në rregullën 32(1) të Rregullores, materiali i sekuestruar mbahet, ruhet dhe mbrohet në mënyrën e duhur. Paneli që autorizon sekuestrimin duhet të saktësojë:

---

<sup>17</sup> Rregulla 37(1) e Rregullores. *Shih gjithashtu*, Aktvendim i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të DHSK-së i 28 qershorit 2017, para. 62-67.

<sup>18</sup> Rregulla 31(1)(c) e Rregullores.

(a) procedurën dhe masat paraprake për ruajtjen, mbrojtjen dhe transferimin e materialit të sekuestruar; (b) kohëzgjatjen e mbajtjes së materialit të sekuestruar; dhe (c) udhëzimet dhe afatet për kthimin ose asgjësimin e materialit të sekuestruar.

13. Neni 35(3) i Ligjit përcakton se policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Në përputhje me nenin 53(1) të Ligjit, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë përmbushin pa vonesë të papërligjur çdo kërkesë për ndihmë, urdhër apo vendim të Dhomave të Specializuara. Bazuar në rregullën 202(2) të Rregullores, gjykatësi i vetëm mund të urdhërojë çfarëdo kushtesh që i gjykon të nevojshme, ndër të cilat edhe kushtet në lidhje me konfidencialitetin dhe masat mbrojtëse. Çdo urdhër i tillë përmbushet pa vonesë të papërligjur në pajtim me nenin 53(1) të Ligjit dhe rregullën 202(3) të Rregullores.

14. Në përputhje me nenin 55 të Ligjit dhe rregullën 208(1) të Rregullores, gjykatësi i vetëm mund të kërkojë bashkëpunimin dhe ndihmën e një shteti të tretë nëse kjo është e nevojshme për hetimin dhe ndjekjen penale të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.

#### IV. DISKUTIM

##### A. KUSHTET E KONTROLLIMIT DHE SEKUESTRIMIT

15. Kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar përfshijnë kontrollimin e z. Haradinaj, të vendarrestimit të tij dhe të zyrave të OVL-UÇK-së, organizatë nënkryetar i së cilës është z. Haradinaj. Gjykatësi i vetëm vlerëson se megjithëse vendarrestimi i z. Haradinaj nuk dihet në këtë moment, ai mund të sjellë pritshmëri të arsyeshme për privatësi.<sup>19</sup> Po kështu, gjykatësi i vetëm vlerëson se në lidhje me zyrat e OVL-UÇK-së të cilat ndodhen në të gjitha katet, me përjashtim të katit përdhes, të ndërtesës në

---

<sup>19</sup> *Shih*, Aktvendim i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të DHSK-së i 28 qershorit 2017, para. 69.

adresën Rruga UÇK 77, Prishtinë, Kosovë,<sup>20</sup> mund të ketë pritshmëri të arsyeshme për privatësi. Rrjedhimisht janë të zbatueshme garancitë mbrojtëse të parapara në Ligj dhe në Rregullore.

16. Në kontekstin e kontrollimit të vendarrestimit të z. Haradinaj dhe zyrave të OVL-UÇK-së dhe sekuestrimit përkatës të sendeve, gjykatësi i vetëm rikujton se ekziston dyshim i bazuar që z. Haradinaj ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.<sup>21</sup> Duke marrë parasysh sa më lart, gjykatësi i vetëm më tej konstaton se ekziston dyshim i bazuar se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar lidhur me vendarrestimin e z. Haradinaj dhe zyrat e OVL-UÇK-së mund të rezultojnë në prova të domosdoshme për hetimin e ZPS-së të veprave penale të lartpërmendura. Gjykatësi i vetëm gjithashtu konstaton se ekziston dyshim i bazuar se prova të tilla mund të gjenden në vendarrestimin e z. Haradinaj dhe zyrat e OVL-UÇK-së. Në kuadër të kontrollimit të z. Haradinaj, duke qenë se pretendohet se ai ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, gjykatësi i vetëm konstaton ekzistencën e dyshimit të bazuar se kontrollimi mund të rezultojë në gjetjen dhe sekuestrimin e provave në lidhje me këto vepra penale. Për arsyet e lartpërmendura gjykatësi i vetëm konstaton se ekziston dyshim i bazuar që përlligj kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar.

17. Për më tepër, duke qenë se në vendarrestimin e z. Haradinaj dhe zyrat e OVL-UÇK-së mund të gjendet informacion i rëndësishëm në lidhje me veprat penale të përfshira në fletarrestim, gjykatësi i vetëm konstaton se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar janë të domosdoshëm për hetimin e ZPS-së. Po ashtu, kontrollimi i z. Haradinaj është i domosdoshëm për arsye se gjatë arrestimit të tij, ai mund të orvatet të fshehë në trup prova të tilla. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i vetëm konstaton se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar janë të domosdoshëm për hetimin

---

<sup>20</sup> Parashtrim Plotësues, para. 2.

<sup>21</sup> Fletarrestimi, f. 1-2.



prej ZPS-së të veprave penale të përfshira në fletarrestim si dhe për procese gjyqësore të mundshme në të ardhmen.

18. Sa i përket kushtit të pashmangshmërisë, gjykatësi i vetëm thekson se z. Haradinaj ka deklaruar publikisht mospërkrahjen dhe mosnjohjen e Dhomave të Specializuara<sup>22</sup> dhe rikujton ekzistencën e dyshimit të bazuar se ai është penalisht përgjegjës për veprat penale të frikësimit gjatë procedimit penal, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës sipas neneve 387, 388, dhe 392 të Kodit Penal.<sup>23</sup> Është e arsyeshme të besohet se deklarimi publik i tij për mospërkrahje dhe mosnjohje të Dhomave të Specializuara, si edhe gatishmëria e tij për pengimin e procedurave përmes veprave penale të lartpërmendura demonstrojnë gatishmëri për ndërhyrje ndaj provave. Rrjedhimisht, gjykatësi i vetëm konstaton se çfarëdo prove që mund të posedojë z. Haradinaj nuk mund të sigurohet në mënyrë tjetër, dhe kontrollimi e sekuestrimi i kërkuar në kuadrin e arrestimit të tij mund të jenë e vetmja masë e efektshme për sigurimin e provave.

19. Së fundi, në lidhje me proporcionalitetin e cenimit që do t'u shkaktohet të drejtave të z. Haradinaj kundrejt qëllimit legjitim të hetimit, gjykatësi i vetëm mund të marrë parasysh ndër të tjera, peshën e veprave penale të përfshira në fletarrestim, kohëzgjatjen dhe shkallën e masave të kërkuara dhe garancitë mbrojtëse që do të zbatohen.<sup>24</sup> Qëllimi legjitim i hetimit është ndjekja penale e z. Haradinaj për veprat penale të përfshira në fletarrestim dhe hetimi i tyre. Lidhur me garancitë mbrojtëse që duhen zbatuar gjykatësi i vetëm mban parasysh faktin se, sikurse mishërohet në rregullat 31-33 dhe 39 të Rregullores, ZPS-ja ka për detyrë të marrë masat përkatëse në lidhje me të drejtën për integritet personal, privatësi apo pronë. Po aq i rëndësishëm është edhe zotimi i ZPS-së se do ta përshtatë kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar dhe/ose do t'u përcjellë informacionin dhe udhëzimet e nevojshme

---

<sup>22</sup> Kërkesa, para. 10; KSC-BC-2018-01, F00125/A01, Shtojca 1 e Kërkesës, f. 1-4, 6-11, 14-15, 17-19; F00125/A02, Shtojca 2 e Kërkesës, f. 13-14.

<sup>23</sup> Fletarrestimi, f. 1-2.

<sup>24</sup> Aktvendim i Dhomës së Gjykatës Kushtetuese të DHSK-së i 28 qershorit 2017, para. 64.



autoriteteve të tjera të mundshme që do të ndihmojnë në kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit, për të garantuar se ato do të kryhen në një mënyrë që përjashton informacion që nuk parashikohet të jetë i rëndësishëm dhe në përputhje me garancitë mbrojtëse të përshkruara në rregullën 39 të Rregullores.<sup>25</sup> Rrjedhimisht, në qoftë se kryhen në përputhje me kushtet e përcaktuara në Rregullore dhe në këtë vendim, gjykatësi i vetëm konstaton se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar janë proporcionalë me qëllimin legjitim të hetimit.

20. Pasi ka konstatuar se janë përmbushur kushtet e lartpërmendura, gjykatësi i vetëm autorizon kontrollimin dhe sekuestrimin që kërkohen, duke qenë se janë në përputhje me kushtet e rregullave 31 dhe 37 të Rregullores.

#### B. ORARI, KOHËZGJATJA DHE SHKALLA E KONTROLLIMIT DHE SEKUESTRIMIT

21. ZPS-ja nuk bën të ditur orën për kryerjen e kontrollimit të z. Haradinaj, të vendarrestimit të tij dhe zyrave të OVL-UÇK-së, dhe të sekuestrimit përkatës të sendeve. Sidoqoftë, nga kërkesa është e qartë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar do të kryhen në kuadër të arrestimit të z. Haradinaj. Duke marrë parasysh nga njëra anë rëndësinë kohore të veprimeve hetimore dhe kohën që i duhet ZPS-së apo cilitdo autoriteti tjetër për organizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, dhe, nga ana tjetër, pritshmërinë e arsyeshme të z. Haradinaj për privatësi si dhe nevojën për mbikëqyrje gjyqësore të zbatimit të këtyre masave, gjykatësi i vetëm gjykon se për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar mjaftojnë 14 ditë nga arrestimi i z. Haradinaj.

22. Kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar duhet të kufizohen në prova që besohet se janë në lidhje me ose mund të jenë të rëndësishme për veprat penale të përfshira në fletarrestim, përfshirë materiale që pretendohet se janë të TFHS-së, ZPS-së dhe/ose Dhomave të Specializuara, dhe çfarëdo provash të tjera lidhur me orvatjet e kohëve të

---

<sup>25</sup> Kërkesa, para. 29.

fundit për pengimin e administrimit të drejtësisë. Ndër sendet që do të sekuestrohen mund të përfshihen: kopje dokumentesh, fotografi, videoincizime, audioincizime, si dhe kompjuterë, telefona, memorie fizike pajisjesh për kopjim dhe pajisje të tjera që logjikisht mund të pritet se përmbajnë prova relevante.

#### C. RAPORTIMI I KONTROLLIMIT DHE SEKUESTRIMIT

23. Në përputhje me rregullat 31(2) dhe 37(4)(b) të Rregullores, ZPS-ja duhet të raportojë për zbatimin e masave të kërkuara. Duke marrë parasysh kohën e nevojshme për përgatitjen e një raporti pas zbatimit të masës së kërkuar, ZPS-ja duhet të dorëzojë një raport brenda 14 ditësh nga përfundimi i kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, ose brenda 14 ditësh nga përfundimi i afatit 14-ditësh të përcaktuar për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, në cilëndo datë të mëhershme. Raporti duhet të përmbajë (a) datën, orën, kohëzgjatjen, vendndodhjen, shkallën dhe rrethanat e kontrollimit dhe sekuestrimit; dhe (b) përmbushjen e kushteve të rregullës 39 të Rregullores.

#### D. MBAJTJA, RUAJTJA DHE MBROJTJA E MATERIALIT TË SEKUESTRUAR

24. Gjykatësi i vetëm e vlerëson të nevojshme që ZPS-ja të ruajë, mbrojë dhe transferojë materialin e sekuestruar në përputhje me procedurën standarde të kronologjisë së mbajtjes në ruajtje. Gjatë kësaj, ZPS-ja duhet të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e materialit të sekuestruar nga humbja, qasja e paqëllimshme ose e paautorizuar, ndryshimi, shpërndarja apo asgjësimi. Në raportin e vet, ZPS-ja informon gjykatësin e vetëm për procedurën dhe masat paraprake përkatëse për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit të sekuestruar.

25. Gjykatësi i vetëm gjykon se për vlerësimin e rëndësisë së materialit të sekuestruar mjafton një afat kohor prej katër muajsh, llogaritur nga data e kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar. Në qoftë se konstatohet se materiali i sekuestruar është i

rëndësishëm për hetimin apo për procese të ardhshme në lidhje me veprat penale të përfshira në fletarrestim, në pajtim me rregullën 33(1)(b) të Rregullores, ZPS-ja mund ta mbajë materialin deri kur ai pushon së qeni i rëndësishëm në lidhje me qëllimin për të cilin është marrë. Në atë rast, materiali i sekuestruar duhet të kthehet ose asgjësohet në përputhje me rregullën 33(2)-(3) të Rregullores. Në qoftë se materiali i sekuestruar nuk lidhet me qëllimin e hetimit për të cilin është marrë dhe nuk është i rëndësishëm për hetimin e ndonjë vepre penale tjetër brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, materiali i sekuestruar duhet të kthehet ose asgjësohet menjëherë, në përputhje me rregullën 33(1)(a)(i) dhe (2)-(3) të Rregullores.

#### E. DORËZIMI DHE ZBATIMI I URDHRIT TË KËRKUAR

26. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar, ose një pjesë e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, do të kryhen në Kosovë, gjykatësi i vetëm rikujton se në përputhje me nenin 35(3) të Ligjit, policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës. Për këtë arsye, në kuptim të rregullës 49(1) edhe ZPS-ja mund të konsiderohet “autoritet kompetent” i aftë për dorëzimin dhe zbatimin e urdhrave të Dhomave të Specializuara, përfshirë të kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar. Rrjedhimisht, gjykatësi i procedurës paraprake autorizon ZPS-në që të dorëzojë dhe zbatojë këtë vendim.<sup>26</sup> Nëse është e nevojshme, ZPS-ja mund ta bëjë këtë në bashkëpunim me autoritetet kompetente në Kosovë.

27. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar ose një pjesë e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar do të kryhen në një shtet të tretë, në përputhje me nenin 55 të Ligjit dhe rregullën 208(1) të Rregullores gjykatësi i vetëm u kërkon autoriteteve

---

<sup>26</sup> Duke e informuar Prokurorin e Specializuar për këtë urdhër, transmetimi i urdhrin konsiderohet i kryer në përputhje me rregullën 49(1) të Rregullores.

kompetente që këtë vendim ta dorëzojnë dhe zbatojnë në praninë e përfaqësuesve të ZPS-së.

28. ZPS-ja parashtron se mund t'i ndalojë përkohësisht z. Haradinaj komunikimet elektronike jo të rëndësishme në vendin e kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit.<sup>27</sup> Duke qenë se ky kusht ndikon në të drejtat e z. Haradinaj gjatë kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, gjykatësi i vetëm e konsideron të nevojshme të vlerësojë dhe sipas nevojës, të përfshijë këtë kusht në vendimin aktual.

29. Gjykatësi i vetëm vlerëson se për të garantuar integritetin e hetimit dhe procedurave në lidhje me të, si edhe sigurinë e personave të pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, ZPS-ja apo autoritetet që e ndihmojnë atë në zbatimin e masave të kërkuara t'ia ndalojnë përkohësisht z. Haradinaj përdorimin e mjeteve për komunikim elektronik jo të rëndësishëm gjatë gjithë kohës së kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, apo të një pjese të tyre.

## V. VENDIM

30. Për arsyet e lartpërmendura, në lidhje me **Nasim Haradinajn**, nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i lindur më 21 maj 1963, shtetas i Kosovës/me shtetësi kosovare (numri personal [REDAKTUAR]), me vendbanim të fundit të njohur në [REDAKTUAR], Kosovë, gjykatësi i vetëm:

- a. **AUTORIZON** kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar në lidhje me kontrollimin e z. Haradinaj, të vendarrestimit të tij dhe të zyrave të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat ndodhen në të gjitha katet, me përjashtim të katit përdhës, të ndërtesës në adresën Rruga UÇK 77, Prishtinë, Kosovë, si dhe sekuestrimin e çfarëdo prove që besohet se është në lidhje me ose mund

---

<sup>27</sup> Kërkesa, poshtshënimi 28.

të jetë e rëndësishme për veprat penale të përfshira në fletarrestim, përfshirë të materialeve që pretendohet se janë të TFHS-së, ZPS-së dhe/ose Dhomave të Specializuara, dhe çfarëdo prove tjetër lidhur me orvatjet e kohëve të fundit për pengimin e administrimit të drejtësisë, sikurse përshkruhet me hollësi në paragrafin 22 të këtij vendimi;

- b. **AUTORIZON** ZPS-në ose autoritetet që do të ndihmojnë në kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar që z. Haradinaj t'ia ndalojnë përkohësisht përdorimin e mjeteve për komunikim elektronik jo të rëndësishëm gjatë gjithë kohës së kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar ose të një pjese të kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar; dhe
- c. **AUTORIZON** ZPS-në ose Administratoren, sipas rastit, që ta bëjë të njohur këtë vendim për aq sa është e përshtatshme dhe e domosdoshme për zbatimin e tij, përfshirë autoriteteve që do ta kryejnë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar.

31. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar ose një pjesë e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar do të kryhen në Kosovë, gjykatësi i vetëm **AUTORIZON** ZPS-në që të dorëzojë dhe zbatojë këtë urdhër në përputhje me paragrafët 21-22 dhe 26 më lart dhe me rregullën 39 të Rregullores.

32. Në qoftë se kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar ose një pjesë e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar do të kryhen në një shtet të tretë, gjykatësi i vetëm:

- a. **URDHËRON** Administratoren që këtë vendim t'ua transmetojë autoriteteve kompetente për dorëzim dhe zbatim;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të këshillohet me Administratoren lidhur me përgatitjet e nevojshme praktike për dorëzimin dhe zbatimin e këtij vendimi;

- c. **KËRKON** prej autoriteteve kompetente që të kryejnë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar në praninë e një përfaqësuesi të ZPS-së dhe me kushtet e mëposhtme, në qoftë se këto kushte nuk cenojnë legjislacionin në fuqi të shtetit të tretë:
- i. kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar të përfundojnë brenda 14 ditësh nga arrestimi i z. Haradinaj;
  - ii. t'i lejohet mbrojtësit të tij dhe një vëzhguesi të pavarur që të jenë të pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, përveç nëse vonesa e tyre rrezikon zbatimin e masës;
  - iii. z. Haradinaj t'i ndalohej përkohësisht përdorimi i mjeteve për komunikim elektronik jo të rëndësishëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar;
  - iv. t'i lejohet përfaqësuesit të pranishëm të ZPS-së që të shënojë orën, kohëzgjatjen, shkallën dhe hollësi të tjera lidhur me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të përgatisë listën e inventarit me përshkrim të hollësishëm dhe informacion për çdo send të sekuestruar; dhe
  - v. materiali i sekuestruar, i cili mund të përfshijë kopje dokumentesh, fotografi, videoincizime, audioincizime, si dhe kompjuterë, telefona , memorie fizike pajisjesh për kopjim, dhe pajisje të tjera që logjikisht mund të pritet se përmbajnë prova relevante, t'i transferohet ZPS-së dhe të mbahet, ruhet dhe mbrohet nga ZPS-ja;
- d. **KËRKON** prej autoriteteve kompetente që të informojnë përfaqësuesin e ZPS-së të pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar për çfarëdo vështirësie ose pengese teknike apo logjistike në zbatimin e këtij vendimi; dhe

- e. **KËRKON** prej autoriteteve kompetente që të trajtojnë kontrollimin dhe sekuestrimin e kërkuar si konfidenciale, dhe ekzistencën dhe përmbajtjen e këtij vendimi t'ua bëjnë të ditur vetëm atyre subjekteve dhe personave përfshirja e të cilëve është absolutisht e domosdoshme për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar.

33. Pavarësisht se ku do të kryhen kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar ose një pjesë e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar, gjykatësi i vetëm:

- a. **URDHËRON** ZPS-në të raportojë mbi kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar brenda 14 ditësh nga përfundimi i tyre, ose brenda 14 ditësh nga përfundimi i afatit 14-ditësh të përcaktuar për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit, në cilëndo datë të mëhershme, në përputhje me paragrafin 23 të këtij vendimi;
- b. **URDHËRON** ZPS-në të mbajë, ruajë dhe mbrojë materialin e sekuestruar dhe të raportojë mbi procedurën dhe masat paraprake për ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit, në përputhje me paragrafin 24 të këtij vendimi; dhe
- c. **URDHËRON** ZPS-në të vlerësojë rëndësinë e materialit të sekuestruar brenda katër muajsh nga data e kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit të kërkuar si dhe të mbajë në ruajtje, kthejë ose asgjësojë materialin e sekuestruar sikurse përcaktohet në rregullën 33 të Rregullores, në përputhje me paragrafin 25 të këtij vendimi.

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatësi i vetëm**

E enjte, 24 shtator 2020



Në Hagë, Holandë.